



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.160/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR, dega në Gjilan për shkak të vendosjes së posterit në shenja të komunikacionit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës-KDI, me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit LDK-AKR, dega në Gjilan i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2,700.00 (*dymijë e shtatëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 08.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës-KDI me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017 në rrugën magjistrale Prishtinë-Gjilan, në udhëkryqin e Novobërdës monitoruesi i tyre ka hasur në poster të vendosur në shenja të komunikacionit, nga një kandidat për deputet nga radhët e Koalicioni LDK-AKR.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicionit LDK-AKR, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, me faktin se janë vendosur posterët në shenja komunikacioni.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2017, Koalicioni LDK-AKR ka theksuar se pas pranimit të Urdhrit për Përmirësim kanë ndërmarrë veprime përmirësuese, me çka është evituar shkelja e pretenduar në ankesë.

Lidhur me veprimet e ndërmarra përgjigjes në ankesë iu ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Koalicionit LDK-AKR është vendosur në shenjë komunikacioni, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vodosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur nen 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga koalicioni LDK-AKR janë vendosur në shenja komunikacioni.

Paneli me rastin e vodosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është e përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor, dhe faktin se posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në shenjë komunikacioni. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se, brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.160/2017 më datën 09.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



[Handwritten signature of Rafet Haxhaj]

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.